

INTERVISTË ME FRANJO GOLLOME

Janjevë | Data: 19 gusht, 2019

Kohëzgjatja: 52 minuta

Të pranishëm:

- Franjo Gollome (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: A mund të prezantoheni?

Franjo Gollome: Unë jam Franjo Gollome, nga Janjeva, kroat. Dhe çka ju intereson tjetër?

Anita Susuri: Diçka për familjen tuaj.

Franjo Gollome: Për familjen tonë? Nuk e di çfarë do t'ju thoja për familjen tonë. Ne jemi janjevas, shumica jemi të mësuar të kemi shumë fëmijë. Gjyshja ime i ka pasur njëmbëdhjetë, nëna njëmbëdhjetë, gruaja ime tetë fëmijë. Do të thotë, unë jam prind i tetë fëmijëve, i kam katër djem dhe katër vajza. Dhe kështu mbijetojmë, blegtori dhe për shembull fëmijët më punojnë gjatë sezonës në Kroaci. Ky është fat që kam arritur t'i rregulloj letrat t'i kem edhe ato kroate. Do të thotë, i kam tri dokumente, e kam letërnjoftimin serb që e kam ruajtur, të Kosovës kur është nxjerrë e UNMIK-ut e Kosovës pastaj e kam nxjerrë edhe të Kroacisë. Sa ka qenë ambasada në Beograd, por po them e kam nxjerrë edhe pasaportën në Prishtinë. Tani në Prishtinë nxjerrim gjithçka në ambasadën tonë dhe kështu.

Ky është një plus i madh, përndryshe nuk do të mund të mbijetonim, vetëm këtu të punojmë dhe vetëm me blegtori nuk mund të mbijetohet. E paraardhësit tanë kanë bërë njejtë kështu, kanë bredhur gjithandej nëpër këto fshatra fqinje dhe shtete fqinje. Kanë shkuar në Bullgari, Rumani me kuaj, do të thotë ashtu është jetuar, pastaj vreshta kanë pasur paraardhësit e mi. Gjyshi më ka vdekur në Amerikë, stërgjyshi. Ka shkuar të fitoj para dhe i ka dërguar para gjyshit tim. Dhe gjithnjë i ka folur, "Bleje këtë arën, bleje atë arën, bleje këtë tokën" dhe kështu do të thotë. "Bleje atë vreshtën, cila është më e mira, atë bleje". Ai dërgonte dollarë nga Amerika. Dhe atje ka vdekur dhe kështu ne i kemi trashëguar vreshtat.

E xhaxhai si fëmijë shkonte nëpër fshatra, me kuaj shiste verë, rrush, pjeshka në Prishtinë afër parkut. Më tregonte ai si i ka shitur. Unë ashtu shkoja në shkollë, filllore, tjetër gjë nuk na interesonte. Menjëherë dy pako, Prishtinë, pazari, kemi punuar kështu deri '90-tën. Pas të '90-tave edhe puna fillon

të zbehet, pastaj unë jam martuar '92-tën. Punë nuk ka pasur, inflacion, vuajtje dhe pastaj vendosa dhe kam filluar prapë me blegtori. Edhe sot, ja me këtë merrem, blegtori, tokën nga pak e kultivoj. E gjithë kjo me mundim, me makina të vjetra do të thotë. Ka organizata, janë disa që ofrojnë, që do të jepin të reja, por prej asaj s'ka asgjë. Dikush po merr, e kush po merr, unë... unë nuk kam arritur të fitoj asgjë, as prej shtetit as prej organizatës, as prej askujt. Por mirë është, në fund të fundit, të mbijetojmë.

Anita Susuri: Unë kam dëgjuar prej shumë janjevasve që gjithnjë, do të thotë kanë shkuar në Amerikë për të punuar edhe stërgjyshi juaj apo gjyshi?

Franjo Gollome: Stërgjyshi, Ivan. Ai ka vdekur në Amerikë.

Anita Susuri: Çfarë kanë punuar ata atje, si kanë shkuar deri atje, a ka qenë ndonjë...

Franjo Gollome: Po ka, vëllau ka zbuluar diçka, të dhëna. Kanë shkuar me anije. Nga 30 ditë e 30 netë kanë udhëtuar. Fatkeqësisht nuk ka janjevas të vjetër, sikur të ishte gjyshja ime gjallë, ajo ka vdekur '99-tën gjatë bombardimeve. Ajo e dinte këngën, sikur të ishte dikush ta këndonte atë këngë dhe ta përmbledh siç ishte. Si ka qenë, "Udhëtuan 30 ditë, 30 netë, 'mendja më lufti fare'. Por kjo është këngë e gjatë, pesë minuta ndoshta më shumë. Ka qenë bukur, mua më kujtohet por nuk më kujtohet si ka qenë ajo. Kështu kanë udhëtuar, me anije shkonin. Gjatë...

Anita Susuri: Ju kujtohet babai juaj, si ka qenë ai? Me çka është marr?

Franjo Gollome: Po vetëm pak, babai më kujtohet normalisht më kujtohet, gjallë e kam babain, ai është në Kroaci. Të gjithë i kam në Kroaci, vetëm unë jam këtu dhe djalin e xhaxhait njërin e kam këtu. Përndryshe të gjithë të familjes tonë janë në Kroaci. Edhe vëllezërit, edhe motrat, xhaxhallarët, hallat, të gjithë janë në Kroaci. Unë kam mbetur, nuk mundem asgjë. Por edhe për neve është fundi siç po duket, nga Kroacia njerëzit po shpërngulen do të thotë të ardhme nuk ka...

Anita Susuri: Çfarë ju kujtohet tjetër prej fëmijërisë?

Franjo Gollome: Çfarë nuk më kujtohet, çfarë nuk më kujtohet. Në shkollë, pastaj pas shkollës hajde puno, do të thotë kjo është...

Anita Susuri: Në cilën shkollë keni shkuar, Vlladimir Nazor?

Franjo Gollome: Shkolla Vlladimir Nazor.

Anita Susuri: Si ka qenë atëherë?

Franjo Gollome: E atëherë ka qenë ndryshe, e kundërta prej tash. Për shembull unë kur shkoja në shkollë, kanë qenë katër paralele me nga 40-38 nxënës. E shqiptarë kanë qenë pesëmbëdhjetë. Mua më kujtohet edhe shokët e shkollës, aty janë, disa jetojnë. E tani ka ardhur e kundërta, shqiptarët janë në katër paralele, e kroatët janë në një paralele dhe numërojnë katër-pesë nxënës, tre nxënës (qesh) dhe dy nxënës. Kështu.

Anita Susuri: A jeni shoqëruar?

Franjo Gollome: Gjithmonë jemi shoqëruar, gjithmonë jemi shoqëruar me shqiptarët, me turqit, me serbët, me të gjithë jemi shoqëruar. Dhe tani, edhe sot, ja unë sot kaloj, kam qenë në Lipjan, nga Lipjani kthehem në Gushtericë, kam marrë pleh, farëra, të gjitha. Miku më, ai më ka pritur që prej vjeshtës e deri tani. Tani kam shitur kurbana dhe pastaj ja dërgova. E takoj, “Shkojmë për kafe”. Shkojmë, unë nuk kam, e shpaguaj, do të thotë shoqërohemi por prapë pak janjevas jemi. Tash ata kanë dhënë e me shqiptarët jemi gjithnjë, ditë e natë gjithmonë bashkë. Do të thotë unë nuk kam komshi tjetër apo fq, do të thotë është shqiptar pas meje, shqiptarë poshtë meje, shqiptarë mbi mua por, gjithmonë jemi shoqëruar. Gjithmonë, gjithmonë.

Anita Susuri: Kur ju keni qenë i vogël, dhe juve sigurisht ju kujtohet ajo jeta familjare, por çka ju ka mbetur më së shumti në mendje?

Franjo Gollome: Po e dini si? Ajo që neve katolikëve na mbetet më së shumti në kujtesë, do të thotë është Nata e Krishtlindjeve, Pashkët, Pashkët përpara, dhjetë ditë përpara thenim, i cakronim vezët. Nëse është e imja më e fortë ia marr vezën dhe kështu. E mbush qesen përplot me vezë. Do të thotë më shumë që na kujtohet, na kujtohen festat tona, Krishtlindjet, Pashkët, do të thotë kemi ne brenda kohëve të shkurtëra festë, festë, festë. Do të thotë më së shumti në kujtim e kemi kishën, fenë, por normalisht aty ka përjetime të ndryshme. Normalisht, kur kemi qenë fëmijë kemi luajtur futboll pastaj ashtu me 15-16 vjet, pastaj kam punuar në Prishtinë e çdo të djelë futboll kemi luajtur. Ekipi me ekipin, do të thotë është një përjetim.

Anita Susuri: A mundeni pak më detajisht, të na i përshkruani pak më detajisht ato, ato festat tuaja? Si i keni...

Franjo Gollome: Po ju them, nuk mund ta dij dikush tjetër sikur ju në mbrëmjen e Bajramit, përgaditja e darkës, do të thotë janë përjetime që njeriu i ndjen, vetëm kush i di. Do të thotë për neve ato janë ditë shumë të mëdha. Për Pashkët shkojmë në mesnatë, do të thotë gjithë natën në kishë për meshë. Pas meshës në konakun e kishës, në shtëpinë e kishës poshtë hare, vallëzim, këndim, pihet. Dhe ashtu njejtë Krishtlindjet, njejtë për të gjitha festat, Shën Kolli dhe kështu. Por vetëm t’ju them, kjo ende festohet në Janjevë, ata të vjetrit, festat e vjetra. Ja njejtë janë edhe janjevasit nëpër Kroaci, ata krejt ndryshe. Pak më ndryshe është, megjithatë është qytet, aty përreth, ku e di unë çka ka aty. Janjeva është Janjevë. Janjeva është vend i veçantë prej të gjitha vendeve në botë.

Janjeva edhe para 30 viteve ka qenë, shqiptarët flisnin që, ky është Cyrihu i vogël, Janjeva. E aty jemi mbledhur le të themi ne janjevasit kemi punuar gjithkund nëpër ish Jugosllavi, edhe jashtë por në ish Jugosllavi. Do të thotë Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja, nuk ka vend ku nuk ka pasur janjevas. Do të thotë paratë janë fituar andej e këtu i kanë hargjuar. Do të thotë këtu kafenetë kanë punuar 24 orë, kurrë nuk janë mbyllur. Edhe verës ka pasur mysafirë e gjatë dimrit le të themi muaji i nëntë, i dhjetë kur vijnë prej detit aty... Kafenetë kanë punuar do të thotë, hargjon populli, punon, punon dhe kur vjen këtu pushon, kënaqet, i hargjon paratë këtu. Do të thotë paraja është rrotulluar këtu në Janjevë. Do të thotë kjo, kjo ka qenë ato vite atëherë, kur filloi lufta çdo gjë filloi të shkatërrohet.

Anita Susuri: A ju kujtohet edhe nëna juaj dhe si kanë jetuar gratë këtu në Janjevë?

Franjo Gollome: E dini çka...

Anita Susuri: Si janë ndarë?

Franjo Gollome: Mua çka më kujtohet dhe çfarë kam dëgjuar, gratë kanë jetuar me mundim, me punë. Gratë kanë punuar shumë atëherë, këto gratë sot nuk punojnë si nënat tona. Ja si sot, ujë nuk kemi qe dhjetë ditë, ne kemi shkuar nëpër burime, i bartnim me duar, me duar dy kova, me duar barteshin, me duar lahej. Do të thotë gratë tepër kanë punuar në krahasim me gratë e sodit. Gratë e sodit i kanë të gjitha kushtet dhe çdo gjë ju mungon. Njëjtë edhe neve njerëzve, kemi, kurrë më shumë s’kemi pasur por gjithmonë na mungon ndonjë gjë.

Anita Susuri: Si ka qenë të jetosh me aq shumë vëllezër e motra?

Franjo Gollome: E bukur ka qenë jeta, dashur ka qenë, bukur ka qenë. Do të thotë ne kemi fjetur në një dhomë aty janë lindur, dy dhoma i kemi pasur por dhoma e madhe e cila është, katër me katër [metra] dhoma e madhe thuhet, aty nuk guxon. Do të thotë në një dhomë ke fjetur, jetuar, shumica, shumica. Do të thotë e tillë ka qenë jeta atëherë. Edhe tani kur vijnë nga Kroacia, tani kanë qenë para disa ditësh, thotë, tridhjetë vjet nuk kanë qenë, thotë, “Po rrugët janë të ngushta”. Unë ju them, “Ne nuk i kemi ndryshuar”. Ai muri është, i Lakes, para njëqind vjet i ndërtuar dhe shtëpia, ajo para 40. “E ajo rrugë është por juve ju duket e ngushtë, ju jeni mësuar tani në gjërësi”. Tani po i bëjnë dhomat dhjetë metra, sallone, e këtu kanë qenë tri metra, katër metra ka qenë dhoma, dhoma e madhe, atje nuk guxon, dhe kështu.

Anita Susuri: A ju kujtohet ajo shtëpia e parë ku keni jetuar ju?

Franjo Gollome: Po me kujtohet mua, ajo është edhe tani aty, unë nganjëherë e vizitoj.

Anita Susuri: Ajo është shtëpi prej çerpiqi¹, dy dhoma, katër me katër dhe aty janë lindur dhe janë rritur dhjetë fëmijë. Por unë jam pak më i veçantë prej njerëzve të tjerë. Do të thotë kur është martuar babai im, unë jam, e para ka qenë motra, pastaj unë, edhe një motër [drejtohet] vëllau, dhe motra. Dhe kur është ndarë babai, mua gjyshi nuk më ka lënë me babain, unë kam mbetur me gjyshin, xhaxhain dhe gjyshen. Unë aty jam rritur por është afër çdo ditë kam shkuar andej-këndej. Por aty jam rritur, pak më ndryshe prej fëmijëve të tjerë.

Anita Susuri: Si, prindërit tuaj janë ndarë apo?

Franjo Gollome: Jo, jo, jo, janë ndarë prej prindërve të tyre.

Anita Susuri: Aha.

Franjo Gollome: E gjyshi mua nuk më ka lëshuar, më ka mbajtur kështu që unë jam rritur me xhaxhain dhe gjyshen. Pastaj kur ka vdekur gjyshi '76-tën kur jam, vetëm një vit përpara, kur është ndarë babai, unë kam mbetur me gjyshin, gjyshen dhe xhaxhain. Xhaxhai nuk është martuar dhe kështu para tetë viteve ka vdekur. Unë mbeta me të dhe mbeta edhe sot e kësaj dite. Ai ka vdekur, unë kam mbetur.

Anita Susuri: A kanë qenë prindërit tuaj afër?

Franjo Gollome: Po, po, 150 metra prej këtu.

Anita Susuri: Si ka qenë, si e keni përjetuar ju?

Franjo Gollome: Po unë ndoshta kam qenë pak fëmijë i llastuar, të gjithë ne fëmijët jemi ngacmuar me shoqërinë aty. Këtu fjalosem me shoqërinë, drejtë, iki lart tek prindërit. Shkoj lart gjysmë ore, një orë, atje fjalosem me fëmijët e fqinjëve, ajo vajza i ka pasur flokët dredha unë ja shkulja pak flokët ajo shkon i tregon nënës time, unë drejtë, iki këndej poshtë dhe kështu.

Anita Susuri: Ju më keni thënë që shumë herët keni filluar të punoni.

Franjo Gollome: Po, klasën e tetë e kam përfunduar, pesëmbëdhjetë vjet, puna. Shumica e janjevasve kanë punuar ashtu.

Anita Susuri: A mund të na flisni pak për këtë?

Franjo Gollome: S'ka, menjëherë kam filluar të punoj në Prishtinë, para Tre sheshirave tek miku Roka, ai është tani në Kroaci. Dhe afër tij, vjen inspekcioni, ai është rrahur me inspekcionin, i'a kanë marr atij

¹ Tulla prej dheut të papjekur, të thara në diell dhe të formësuara me dorë; janë të pasura me argjilë dhe shpesh janë bërë duke ju shtuar kashtën.

diçka mall, unë ja shpëtova mallin, mua ma kanë marr atë klasin, të gjithë mallin ma kanë marr. Mbeta me borxh, pastaj aty te Tre sheshirat, ka qenë ai Dulle, “Hajde” thotë, “Franjo” thotë, “puno këtu”, thotë, “në qebaptore”. Fillova në qebaptore, aty ka qenë nxehtë. Ja, disa ditë, nuk po shkon, rrogën e kam pasur le të themi dy herë më të vogël se sa që do ta fitoja këndeje. Pastaj prapë e mora me borxh mallin tjetër, fillova prapë dhe kështu, kështu ka shkuar deri ‘89-tën.

‘89-tën kam shkuar në ushtri, në UPJ², ‘90-tën në fillim kam ardhur, kam filluar prapë, kam vazhduar punën, puna zhdukej, janjevasit pastaj filloi lufta. Kroacia, Serbia, së pari sllovenët pastaj Kroacia, ka filluar lufta prapë punoja, ashtu puna ra dhe policia nuk lejonte të punohej. Do të thotë unë punoja në të zezë, nëpër rrugë, patrulla, “Ma jep letërnjoftimin”, kur e shikonin, “Franjo”. “A” thotë, “Tugjman” thotë, “ju ashtu, ju kështu”. Maltretime nga ana e policisë, do të thotë emri më shumë nuk më lejonte të punoja. Do të thotë sapo ta merr letërnjoftimin, “A ju i vrisni tonët”, thotë, “ti dëshiron të punosh këtu”, thotë, “mos të shoh”. Më kanë maltretuar, dhe pastaj ‘92-tën, ‘93-tën jam tërhequr dhe kam filluar zanatin e vjetër që xhaxhai është marr me blegtori dhe deri sot merrem me blegtori.

Por megjithatë këto vitet e fundit, do të thotë çka do që prodhohet, e tëra shitet. E bëjmë djathin, djathi shitet. I kemi kualitative delet dhe dhitë, dhitë e egra, dhitë e kuqe, këto i kërkon Prishtina. Sa miq, sado që ka, do të shitej e unë nuk e shes nga një në mëngjes, por sa ka aq ju shes fqinjëve janjevas. Ata gjithashtu e bëjnë djathin e shtëpisë, djathin tonë janjevas. E sa i përket sallamit janjevas, suxhukut, nuk mund ta bëj askush. Djathin janjevas nuk mund ta bëj askush. Edhe ata pyesin çka është në pyetje, unë ju kam shpjeguar atyre, duart janë në pyetje.

Ajo dora që e bën sugjukun, që e di kur e gatuan, sa e gatuan dhe sugjuku i Janjevës, djathin gjithashtu edhe gruaja ime e ka pranuar atë nga gjyshja që duhet ta di ngrohtësinë e saktë të qumshtit kur ja shton tharmin e sa tharm duhet të ketë nëse vetëm pesë minuta e tejkalon ajo do të thotë ai thotë e ka ngrënë hirra, do të thotë. Me të vërtetë kjo është ajo, me këtë merremi. Këto vitet e fundit tani edhe kurbana po mbajmë, kualiteti është në pyetje, njerëzit e dijnë...

Anita Susuri: Janjeva mjaft ka qenë para viteve të ‘90-ta, mjaft ka pasur...

Franjo Gollome: Plot, përplot. Ka pasur kafene, kanë qenë kafenetë do të thotë ne nga kisha menjëherë në kafenenë e Vrevit, prej Vrevit është hapur edhe Joca, Nace e ka hapur por aty ka qenë e vogël {gromëson} poshtë është Shkorlini, e Savinit, e Tinçes, e Tome Toçes, do të thotë kanë qenë pesë-gjashtë kafene. Përplot, nuk mund, nuk mund të vish deri te pija, ta pijsh një pije do të thotë kjo ka qenë atëherë le të themi tetë, nëntë, ‘90-ta. Një, dy, [‘91, ‘92] tashmë kishte filluar shpërngulja, kroatët janë shpërngulur janë frikësuar njerëzit dhe kështu në shpejtësi edhe janë shpërngulur. Do të thotë deri të ‘95-tën Janjeva 90 për qind ka shkuar.

² Ushtria Popullore Jugosllave.

Anita Susuri: A mundeni pak me detaje të ma përshkruani kur keni qenë ju i vogël, si e kujtoni Janjevën, atë çarshinë dhe ato rrugët e ngushta, pak të na i përshkruani ju ato.

Franjo Gollome: Po unë mund ta kujtoj Janjevën si fëmijë, kur shkoja gjyshit t'i blej '75-tën cigare që çarshia ka qenë e mbushur me njerëz, aty ka pasur njerëz qesharak që kanë ditur të bëjnë rrengje dhe të bëjnë shaka dhe të flasin. Dhe sot unë frikësohem, këto dy vite mua më ka hyrë në kokë që fëmijët tonë, do të harrojnë të flasin, ata janë në telefon. Unë mendoj 24 orë po t'i lejoje në telefon do të thotë do të harrojnë edhe të flasin. Njerëzit kanë ditur të flasin, të bëjnë shaka, të ndërtojnë tregime dhe si fëmijë më kujtohet cigare blej. Por edhe kur jam rritur pak më i madh, dal pastaj atje '86-tën, '87-tën kur janë hapur kafenetë, unë djalosh pastaj '88-'89 pastaj... Kjo ka qenë, ku ta di unë, nuk mund ta përshkruaj askush. Bukur ka qenë, shoqëri ka pasur, edhe me shqiptarët jemi shoqëruar dhe futboll kemi luajtur edhe sot shoqërohemi.

Anita Susuri: A kanë dalur nëpër kafene vetëm meshkujt apo si ka qenë me vajza?

Franjo Gollome: Jo, jo, jo, kanë filluar edhe vajzat të dalin. Do të thotë '88-'89-tën kanë filluar edhe vajzat të dalin, do të thotë aty jemi njohur, aty jemi martuar, në kafene.

Anita Susuri: A mund të na përshkruani pak atë stilin e janjevasve? Do të thotë unë kam dëgjuar që shumë mirë janë veshur, do të thotë kush ka pasur pak më shumë, ka... Do të thotë kanë qenë disi karakteristik janjevasit.

Franjo Gollome: Po ashtu, me të vërtetë kemi pasur para nëpër duar. Dhe nuk është vetëm e rëndësishme të pasur dhe të varfër, të cilët nuk kanë pasur aq para, fëmija për gjëra ka pasur. Do të thotë megjithatë ka fituar për vete të vishet, që të, për dalje dhe kështu. E ka për shembull individë që kanë pasur pare të madhe. Por dora jonë jo, mendoj si gjithmonë, kemi pasur sot për nesër, kemi pasur para nëpër duar, kurrë nuk ka ndodhur që të mos kemi por ka individë që kanë pasur shumë para po edhe sot ka që kanë shumë para, të cilët kanë edhe për jetë para dhe kështu. E për gjëra të bukura gjithnjë kemi qenë, të gjitha më të shtrenjta do të thotë ky punon në Prishtinë, ai nga Turqia mi sjell farmerkat, ma sjell orën, dyqind marka. Çka ka qenë, ajo është por unë ato para i fitoj aty afër tij. Punojmë bashkë, mi sjell farmerkat, këto farmerka, ato, visheshim vërtetë ekstra. Ashtu do të thotë, këtu nuk keni gabuar. Kemi qenë të veçantë.

Anita Susuri: Gjithashtu ka qenë, ka qenë edhe Shtëpia e Kulturës dhe?

Franjo Gollome: Po, ajo është, pak më kujtohet, pak më kujtohet. Kur ka qenë Shtëpia e Kulturës dhe pastaj në ballo aty kanë shkuar edhe meshkujt edhe femrat. Do të thotë kanë filluar, janjevaset kanë filluar të dalin, kanë filluar atëherë, ne e kemi thirrur kino salla, Shtëpia e Kulturës pastaj njejtë për 1 maj atëherë kur kam qenë i vogël, 1 maj në mes të çarshisë në skenë muzika, vallëzim, aty vinin edhe gratë për shembull për 1 maj. E ka qenë e gjithë kjo e bukur por nuk ka më asgjë prej asaj.

Anita Susuri: A ju kujtohet për shembull, një ditë e tillë si ka qenë, në atë ballon për 1 maj? Si ka qenë, për shembull na përshkruani.

Franjo Gollome: Po besom, unë i kam ikur atyre turmave. Gjithnjë kur aty mblidhen unë drejtë, iki në ndonjë kafene, në ndonjë lakore ose me shoqërinë ose me ndonjë vajzë t'i iki turmës dhe kjo është. Ja, nuk më kujtohet ajo dita por më kujtohet mbrëmja e maturës. Do të thotë e përfundoj klasën e tetë, jemi mbledhur aty te kino salla, ja kjo më kujtohet, kino salla do të thotë mbrëmja e maturës, kjo mund të mbahet në mend. Kanë qenë dy motra, bashkë kemi qenë në klasë, vajza e tezës dhe unë, shoqe dhe kështu.

Anita Susuri: Desha t'ju pyes edhe pak për ato daljet dhe muzikën. Pasi që mjaft kanë kënduar në Janjevë, edhe këtë e kam dëgjuar.

Franjo Gollome: Po.

Anita Susuri: Juve ju kujtohet kjo, si ka qenë?

Franjo Gollome: Po kanë qenë ato, kanë qenë ku ta di unë, boshnjake, ato këngët maqedonase, këngë popullore, këngë popullore, muzikë e bukur ka qenë. Sot është gjithçka ndryshe. Por ne njejtë i mbajmë edhe në Kroaci, tani kam ja tani këto dy vite kam filluar, i kemi letrat, i kemi të gjitha, tani mundet e shkoj në dasma edhe në Kroaci. Unë mendoj dasmat, kjo është ajo, muzikën prapë ne, për shembull në shpirt e kemi "Ajde Jano, 'ajde shpirt" a po më kupton, ajo kënga, do të thotë ne atje e vazhdojmë atë traditë. Diçka më moderne por tradita është traditë. Do të thotë nuk heqim dorë nga tradita.

Anita Susuri: Janjevasit janë mjaft besimtar të devotshëm, do të thotë kështu kam dëgjuar. E ju, a keni qenë edhe ju pjesë e atij stilit të jetës? Do të thotë gjithmonë ka qenë në qendër kisha dhe gjithmonë të gjithë shkonin në kishë.

Franjo Gollome: Po unë mendoj se secili janjevas është besimtar, por mund të them vetëm për vete. Unë gjithmonë kam qenë besimtar dhe deri në varr do të jem besimtar. Do të thotë unë të djelën nuk e humbas, unë shkoj në kishë. Më herët nuk kam mundur, kur fëmijët ishin të vegjël, nuk mund t'i mbyll unë delet, 200 copa, të shkoj në kishë. Por sapo janë rritur fëmijët, atëherë kishën nuk e humbas. Edhe sot e kësaj dite për shembull edhe për Shën Antonin në Prishtinë patjetër shkoj. Engjujt Mbrojtës në Ferizaj është kisha, festë, unë e nder kombin dhe shkoj.

Stublla, Shën Josipi, Nëna e Perëndisë tri ditë kam shkuar, sipas traditës. Gjyshi ka shkuar, babai ka shkuar, tani po e vazhdoj edhe unë. Të paktën tri ditoren te Nëna e Perëndisë në Letnicë, Shën Jozefin në Stublle, këtë vit nuk kam mundur, në Dunav njejtë e kemi Shën Anën do të thotë ne tradicionalisht i

mbajmë këto festa... E jo të gjithë, ka disa nuk shkojnë nga një vit në kishë, për mua është kjo qesharake, unë kur bisedoj me ta, unë pikërisht lidhur me këtë flas. Si është e mundur që...

Anita Susuri: E keni përmendur edhe Nënë e Perëndisë, dhe Letnicën. Dhe e di që janjevasit shkonin nga një muaj atje në Letnicë... Si ka qenë kjo?

Franjo Gollome: Po, pikërisht ashtu. Kjo ka qenë njëjtë diku viteve të '80-ta, ndoshta edhe më herët, shkohej nga një muaj në Letnicë. Po them, shumica burrave kanë qenë në lëvizje por gratë, familja me fëmijët shkonin atje, edhe burrat që donin, le të themi tani edhe unë jam burrë dhe ne nuk e lëmë atë. Do të thotë tradicionalisht është shkuar edhe më herët, edhe para 50 vjetësh, unë e di se gjyshja na tregonte që gjyshi mbetej pa para, që merrte para, i huazonte, i huazonte, merrte edhe me kamatë, që thuhet në gjuhën tonë me fajde.

Gjyshja më tregonte, "Nuk kemi para për Letnicë, Kola e dërgon një fëmijë, merr fajde merr para, shkonim, nuk e lënim". Dhe ne gjithmonë shkojmë. Vetëm '99-tën nuk kemi qenë dhe gjyshja na ka vdekur dhe pastaj menjëherë '99-tën xhaxhai ka shkuar me gruan time dhe fëmijët e mi. Unë kam mbetur në shtëpi me delet dhe do të thotë tradicionalisht gjithmonë shkojmë. Ajo është traditë e jona, i kemi ne atje disa strehë, mëkat që s'keni ardhur t'i shihni ato.

Anita Susuri: Kam qenë, kam qenë.

Franjo Gollome: A ke qenë? A e ke parë?

Anita Susuri: Po.

Franjo Gollome: Mëkat që s'të kam parë, unë kam qenë atje.

Anita Susuri: (qesh) Ka pasur shumë njerëz.

Franjo Gollome: Por do të jetë tani prapë, më 8 shtator. Do të thotë megjithatë njerëzit janë në sezonë, këta nëpër Kroaci, nëpër Kroaci. E tani më 8 janë më të lirë, sezona është kah fundi e ka mjaft [njerëz] nga Kroacia vijnë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Më keni folur për Letnicën a mundeni pak më detajisht për ato ditët, si keni kaluar, çfarë keni bërë atje?

Franjo Gollome: Mund t'ju them, unë e mbaj në mend të moshuarit tonë shkonin me qetë, gjyshi. Pastaj kur unë kam qenë fëmijë kam shkuar me babain, me familjen, vëllezërit, motrat, me xhaxhain. Shkonim me kuaj dhe ato janë përjetime të mëdha. Fëmijërinë njeriu gjithmonë e kujton. Pastaj kur mbërrinim atje, shkonim nga shtatë ditë. E gjenim shtëpinë, e merrnim me qera, si tani 100-200 euro për ato shtatë ditë, kuaj blejmë, tërfillin, dhe i çonim për të pirë ujë tek lumi. Pastaj ne si fëmijë kënaqeshim në lum, laheshim, bënim vorbulla pastaj lart ka qenë diga thuhet, burime, blenim shalqi, e fushim në ujë, burimi. Dhjetë minuta, uji i ftohtë, e hamë.

Pastaj si rritesha, pastaj kemi filluar me vajza por e njëjta është, ajo ka qenë bukur. Ky është përjetimi jonë, i paharrueshëm. Edhe sot shkojmë por unë vajzën e kam pasur dhe në Letnicë e kam dërguar vetëm deri te mulliri, do të thotë edhe mulliri është mbyllur. Ai pronari është njeri i vjetër, afro 90 vjet, e ka pasur një punëtor, ai ka vdekur para dy-tri vitesh, nuk e takoj më. Do të thotë sa herë që kam shkuar në Letnicë, kam blerë miell të misrit. Do të thotë prej mullirit, mullirit me ujë.

Anita Susuri: A shkojnë edhe tani njerëzit atje të qëndrojnë me ditë, a ka ndryshuar ndonjë gjë?

Franjo Gollome: Paj nuk ka ndryshuar... Ka ndryshuar, si nuk ka ndryshuar, për një mijë për qind, se jo vetëm njëqind për qind ndryshim. Do të thotë aty kanë qenë njejtë kroatët e Letnicës. Ata janë pak të çuditshëm edhe ajo gjuha, edhe në bisedë dhe me sjellje të çuditshme. Për neve ata kanë qenë interesant por edhe ata njejtë janë shpërngulur nëpër Kroaci, unë mendoj që tani janë, e kam pyetur një të moshuar, që kanë mbetur vetëm tetë kroatë, edhe atë pleq. Do të thotë edhe ata janë zhdukur.

Anita Susuri: Në Letnicë, apo jo?

Franjo Gollome: Po por ka shqiptarë, katolikë të cilët shteti... është edhe kisha, është edhe kafeneja që e mban njëri. Është ai Froko dhëndri i tij, përball tani e ka hapur kafenen e re. Kafeneja e rregulluar mirë dhe mirë punon. Të paktën kam dëgjuar që mirë punon.

Anita Susuri: Unë gjithashtu e di që atje janjevasit kanë jetuar dhe i kanë pasur të gjitha aty, aty do të thotë kanë ngrënë, kanë pirë...

Franjo Gollome: Po, po. A e dini çka, kasapët tonë nga Janjeva, dhe kasapë ka pasur mjaft Janjeva, kanë qenë shtatë-tetë. Do të thotë e gjithë kjo, sa është therur, sa sugjuku është bërë, e gjithë ajo është shitur. Tani e kemi vetëm një, edhe ai ka probleme. Vitin e kaluar nuk ka punuar, e kanë vjedhur, ajo kjo, nuk ka punuar. Por vetëm njëri punon edhe ai nuk mundet, nuk mundem as unë të vij në rend t'i marr dy kilogram sugjuk për shtëpi. Do të thotë kjo është, ka qenë plotësisht ndryshe, kanë ndryshuar mjaft gjëra.

Anita Susuri: Këtu në Janjevë ka qenë edhe maskenballi apo *mashkare*³, a është ashtu?

³ Karneval që bëhet para Kreshmës. Zakonisht njerëzit bëjnë maskime të ndryshme.

Franjo Gollome: Po, po, kjo është ajo, ato kanë qenë përjetime. Por tradicionalisht ne sot, kur është ajo ditë, këtë vajzën time të vogël e veshin me veshje të vjetër janjevase, dimijat, mintanin⁴ dhe ku ta di unë. Po mendoj, i kemi ne aty edhe fotografitë por vetëm se nuk e di ku janë. Do të thotë megjithatë e ruajmë por vetëm një fëmijë, atëherë të gjithë në rend secili, e maskohu në përbindësja, pastaj në *bauk*⁵, e frikësoji fëmijët, frikësoji njerëzit. Kishte gjithçka.

Anita Susuri: Si janë dukur ato maskat?

Franjo Gollome: E dini çfarë, unë mendoj '85-tën, '90-tën po të vinte dikush ta shikonte Shëngjergjin tonë më 23 prill është festuar nga katër-pesë ditë. Dhe për neve ka qenë përjetim, jo në shtëpi, shumica prej neve kemi ngritur tenda nëpër kodra. Tri-katër ditë aty është ngrënë, pirë. Pastaj unë si djalosh më kujtohet shkoja në ato livadhet për të vjedhur, tek ne vidhet, është zakon të vjedhësh ndonjë gjë. E unë shkoj në ato livadhe dhe i mbledh të gjitha papuçet, këpucët, të gjitha në thes dhe në shtëpi. Pastaj nesër i kthen. Ashtu ka qenë tradita. E gjithë ajo ka qenë përjetim i bukur, po i 23-ti, Shëngjergji ynë është më 23 prill. Kurse Shëngjergji i vjetër më 6, 5 maj, 5 maj.

Anita Susuri: E *mashkare*, pse ajo festohet? Si është?

Franjo Gollome: Tek ne quhet *pokllade*, për *pokllade*, do të thotë ajo është *mashkare*. Ka edhe nëpër botë, në çdo vend por ne e quanim *pokllade*. Do të thotë për *pokllade* ne jemi veshur me gjëra të shëmtuara, gjëra të bukura, të dukemi keq, ta frikësojmë dikë dhe kështu.

Anita Susuri: E si kanë qenë ato maska, si i keni bërë?

Franjo Gollome: Po maskat, dikush e merr lëkurën e deles, dikush e merr pallton e shqyer, të kthyer prej brenda, dikush maskohet në gjithçka, gjithçka kemi shpikur ne. Ngjyrosemi me ngjyrë të zezë, pastaj pastrohu dhe kështu, po, *mashkare*.

Anita Susuri: Ju do të thotë deri në klasën e tetë keni qenë këtu në Janjevë, a është ashtu? Apo jo?

Franjo Gollome: Unë gjithmonë kam qenë në Janjevë, pesëdhjetë vjet i kam mbushur në Janjevë.

Anita Susuri: Jeni shkolluar në Janjevë?

Franjo Gollome: Jam shkolluar në Janjevë, shkolla e mesme ka qenë në Gushtericë, Lipjan. Do të thotë unë filloren, shumica prej neve janjevasve e përfundon filloren, pakot në duar, puna.

⁴ Pallto e shkurtër me mëngë të ngushta e të gjata, lloj i veshjeve të sipërme të burrave dhe grave.

⁵ Kafshë nga mitologjia sllave. Përshkruhet si krijesë që fshihet nëpër vende të errëta dhe pret viktimën për ta ngrënë; mund të dëbohet me dritë dhe zhurmë.

Anita Susuri: A mund të na tregoni pak më shumë për këtë?

Franjo Gollome: Po nuk e di...

Anita Susuri: Pse për shembull nuk jeni shkolluar më shumë?

Franjo Gollome: Po njejtë ka shkuar sipas traditës, do të thotë për tu shkolluar nevojiten para. Do të thotë tonët i kanë ikur kësaj, shumë fëmijë janë lindur, që po ju them, dhe nëse një prind, aty duhet shumë para për t'i shkolluar të gjithë fëmijët. Do të thotë fëmija rritet deri në klasën e tetë, shtesa për fëmijë merret nëse ata punojnë te Metaliku, e jo fëmijët me pako, do të thotë vetëm për vete fiton. Do të thotë për katër-pesë vite diçka fiton, martohet 20 vjet, 25 dhe do të thotë vet për vete. Prandaj edhe shumë fëmijë janë lindur, sapo është bërë kjo demokracia, kjo botë kështu të mendoj, do të thotë sot duhet fëmijës t'ia përgatisësh të gjitha që të martohet, që të ndahet dhe kështu.

Anita Susuri: Kur keni shkuar ju për herë të parë larg Janjevës çfarë përjetimi ka qenë për juve? Ku keni udhëtuar?

Franjo Gollome: Po a dini çka unë po ju them juve që jo gjatë, larg nuk kam udhëtuar si janjevasit tonë. Do të thotë unë aty në Prishtinë kam punuar, kurrë nuk kam fjetur atje do të thotë gjithmonë kam udhëtuar. Autobusi në mëngjes në 7:15, në Prishtinë. Prishtina është afër, kur ndonjëherë vonohet do të thotë i fundit ka qenë në shtatë, shkoj atë ditë deri në Kishnicë, prej Kishnicës në këmbë përmbi për të ardhur deri në Janjevë. 45 minuta ecje dhe kështu.

Anita Susuri: Si ju është dukur Prishtina atëherë?

Franjo Gollome: Po le të themi njejtë si sot (qesh) mua ndoshta që jam këtu e asgjë s'më duket ndryshe. Po, po e shoh unë që ka ndryshime këtu nuk kam qenë dhjetë ditë, dje shkova deri te tregu i madh, një mik nga Zagrebi t'i shohim disa pëllumba. Kur hymë dhe unë atij t'ia shpjegoj që të shkojmë nëpër autostradë që të mos hyj në Prishtinë, kur po e shikoj atë... E tëra e shkatërruar, çka do të jetë kjo ndonjë rreth me siguri, rrethi do të jetë. Dhe i'a shpjegoj, thash, "Shiko Pasha, këtu kështu do të hysh që të lidhesh menjëherë në autostradë, që të mos shkosh nga qyteti këndeje". Do të thotë çdo ditë diçka ndryshon por unë ndoshta që jam këtu e për mua është njejtë ajo. Çdo e treta, e dhjeta, e pesëmbëdhjeta, njëzeta ditë nuk kalon e ashtu shpesh të jem përdit në Prishtinë, Lipjan dhe kështu, gjithmonë në lëvizje.

Anita Susuri: Kur keni qenë në ushtri, ku keni shkuar?

Franjo Gollome: Vaj, vaj, vaj, çfarë përjetime kanë qenë ato. Do të thotë atëherë ka qenë traditë, kushdo që shkon në ushtri, ka përcjellje, e përcjellja do të thotë të gjithë prej kushërinjve duhet të

vijnë, të të përcjellin në APJ [Armata Popullore Jugosllave]. Prej shoqërisë e shokët do të thotë kanë qenë dhomat përplot, tarraca përplot, oborri përplot. Aty pihej, hahej, përcillej, pastaj nesër e unë afër kam qenë, në Mitrovicë, në Mitrovicën e Titos, Mitrovica e Veriut tani, aty kam qenë në ushtri. Pastaj unë me vetura të mia, tri vetura kemi shkuar, edhe shoqëria edhe xhaxhai dhe të gjithë të më përcjellin deri te kazerma. Përndryshe ka qenë traditë, shkohet në ushtri, përcjellja në mëngjes apo ndonjë taksì, apo të dërgojnë deri te Fushë Kosova pastaj me tren, me tren, shkohej. Mua së pari më ka ardhur për Slloveni.

Unë shkoj me gjyshen, gjyshja poshtë në komunë filloi, e kemi pasur një njeri poshtë. “Unë një bir të nënës e kam, të më shkoj në Slloveni, nuk mund të duroj, unë nuk mund të shkoj ta shoh, më vjen për të vjellë në autobus”. Pastaj ai thotë, “Gjyshe hajde, a dëshiron ti të shkosh në ushtri”? I thash, “Unë dua por gjyshja nuk po më lë, larg është”. “A dëshiron ta jepi diku afër”? them unë, “Dua në ushtri por larg është. Prandaj po e shtyejmë”. Thotë, “A dëshiron në Mitrovicë”? Pastaj i them në cilën Mitrovicë “Në cilën Mitrovicë?” “Po sa Mitrovica janë?” “Po është e Sremit, është e Titos”. Pastaj thotë “Në tonën, Mitrovicën e Titos”. Pastaj them, “Si jo”. Për një muaj kam shkuar në APJ. Pastaj APJ ka qenë përjetim, nuk mund ta besosh. Le të themi atje njejtë, e bën shoqërinë dhe ku ta di unë. Prapë më mirë është ushtria se sa pa ushtri.

Anita Susuri: Dhe kur jeni kthyer nga ushtria, a jeni martuar atëherë apo a ka qenë ashtu një rregull?

Franjo Gollome: Paj jo, jo. Po ashtu ka qenë zakoni tek ne, por tashmë, ka filluar më shumë nëpër kafene dhe ashtu, unë e kam pasur të dashurën edhe para ushtrisë, dhe kam ardhur prej ushtrisë kemi kaluar, e treqind çudira ka pasur aty. Gjithçka dhe çdo gjë.

Anita Susuri: Dhe kur jeni martuar?

Franjo Gollome: Atëherë ‘93-tën me këtë gruan tani.

Anita Susuri: Më flisni pak më shumë për gruan tuaj, si jeni... ku jeni parë, ku jeni takuar dhe kështu.

Franjo Gollome: Po e dini çfarë, Janjeva është vend i vogël, do të thotë çfarë ka, nuk ka as njëqind metra prej meje këtu. Unë e kam njohur atë dhe pastaj shkon motra për të blerë diçka, unë i them, “Ku është Mare, si është, përshëndete”. Atëherë unë kur e përshëndes, ajo vjen në kishë më sheh hajde te unë dhe kështu ka shkuar gjithë kjo tek ne. Tradicionalisht ka shkuar ashtu, kështu njiheshim pastaj filluan ato kafenetë, pastaj çdo mbrëmje dalje. Ajo te tezet, te ai, te ky, çdo mbrëmje shiheshim, kalonim dhe erdha deri te ushtria. E pastaj po ju them, lufta filloi pastaj aty kanë qenë ndryshimet. Ndryshe, do e marr e s’do e marr nuk mundem, e dua të shpërngulem, nuk dua të shpërngulem. Dhe kështu, të mos flas, kështu kjo qenë.

Anita Susuri: Do të thotë para se të martoheshit ju, ajo është para të '90-tave, diçka ka filluar të ndryshoj në Janjevë në atë periudhë. A ju kujtohet ai përjetim?

Franjo Gollome: Si po mendoni ndryshime?

Anita Susuri: Kur ka filluar ndryshimi në Janjevë, do të thotë mjaft njerëz kanë filluar të shkojnë që këtu?

Franjo Gollome: E gjithë kjo ka qenë '92-tën, '93-tën deri '95-tën. Shpërngulje e papritur. Ka qenë shpërngulje e papritur. Ajo ka qenë shpërngulje e papritur. Deri sa edhe tani kanë shkuar, para dy muajsh, një familje ka shkuar. Vitin e kaluar njëra, dhe ku është problemi? Të rinjtë nuk po kthehen. Ja djali im i ka 27 vjet, tjetri i ka 25, vajza 24, e katërta 20. Do të thotë kështu tonët shkojnë në sezonë ose e gjen vajzën, mbetet atje, nuk kthehet këndej do të thotë kështu ne pakësohemi, pak nga pak. Edhe ndonjë familje shkon do të thotë, varësisht prej vitit, më pak, e më pak, e më pak, e më pak. Ky është problemi. Ndoshta edhe nuk është problem, ndoshta edhe duhet të shpërngulen.

Anita Susuri: Jo, pse?

Franjo Gollome: Po nuk e di. Ndoshta atë e di Zoti.

Anita Susuri: Ju më keni folur për sezonën, do të thotë për të rinjtë që shkojnë të punojnë atje.

Franjo Gollome: Po.

Anita Susuri: A ka qenë gjithmonë kështu? A shkonin gjithmonë në sezonë?

Franjo Gollome: E dini çka, do të thotë ne gjithmonë, ju kam thënë, e kemi mbajtur ish Jugosllavinë, do të thotë nuk ka vend, nuk ka qytezë, nuk ka fshat ku nuk ka pasur janjevas. Do të thotë gjithnjë kemi shkuar por tani le të themi, ku do të punësohej biri im? Nuk ka ku të punësohet, dhe është fat i madh që atje kanë punë. Apo ku do të punësohet, këtu të punoj për 250-300 euro... Problem është sa i përket punës për neve kroatëve. Neve para dy-tri vitesh ambasadorja jonë e ka kërkuar një vajzë e cila atje në ambasadë do t'i bënte kafe, të pastroj, atë këtë. Janë lajmëruar katër-pesë vajza tona, asnjëra nuk është përzgjedhur. Nuk e di as kush ju punon atje por problemi është, pse nuk e ka punësuar ndonjë vajzë tonën? Po ai fëmijë do të qëndronte këtu 365 ditë, e jo të shkoj atje për sezonë, vjen këtu sa nuk punon apo për Vitin e Ri shkon. Do të shkoj te xhaxhai, do të shkoj te gjyshja, do të thotë nuk e di, nuk e di, nuk jam aq i mençur ta studioj edhe këtë.

Anita Susuri: Por prapë ata do të thotë janjevasit që kanë shkuar për Kroaci, ata kthehen për ato festat dhe ato. Si është atmosfera kur ata vijnë? A ndryshon ndonjë gjë?

Franjo Gollome: Po ta dini, si nuk ndryshon. Ndryshimi njëqind për qind, në dy-tri ditë. Këto dy-tri ditë do të thotë kafenetë punojnë, përplot. Ne jemi popull i thjeshtë, të hamë, të pijmë, i harxhojmë paratë. Nuk jemi si dikush tjetër, hyn në kafene, e merr një lëng, tri orë qëndron me një lëng. Ne hyjmë dhe ende nuk jemi ulur, e pijmë rakinë, na jep këtu një raund, na jep këtu një raund. Ne për një orë i pijmë dhjetë raunde të pijeve, të tillë jemi. E ndryshime ka, si jo, edhe për neve kanë domethënje ndryshimet kur ata vijnë, na vjen mirë. E tani kur një nga një i përcjellim ja sot në ora 5 të mëngjesit, shkon miku, po kthehet. Pastaj pasdite tjetri, pastaj prapë mbesim si jetimë dhe ku ta di, nuk e kemi të lehtë.

Anita Susuri: Ata filluan të shkojnë që këtu '90-tën, '91-tën mendoj kur ka qenë Shesheli këtu në Janjevë. A ju kujtohet juve ajo ditë kur ai ka qenë këtu?

Franjo Gollome: {ndez cigaren} Mua nuk më kujtohet ajo ditë, unë vetëm kam dëgjuar tregime, me siguri nuk kam qenë aty. Po them, gjithmonë jam edhe sot jam diku në lëvizje, thash, më keni thirr e unë në Lipjan. Më thirr vajza, thotë, “Babi, sa më shpejtë hajde, duhet, kam harruar, duhet në shkollë [të shkoj], e kam një të dobët, duhet të shkoj në provim”. Unë vrapoj shpejtë prej Lipjanit, herën e dytë më thërrisni, unë në Llapllasellë. Prej saj, prej vajzës kthehem në Graçanicë të marr diçka, vrapoj ta marr atë dhe kur erdha, e tani të pushoj pak dhe pastaj ju thirra. Do të thotë gjithmonë jam në lëvizje, gjithmonë kam qenë edhe më herët. Por mua nuk më kujtohet që ka pasur miting në Janjevë, ashtu kam dëgjuar që ka pasur miting dhe thotë ai kur shkoi poshtë, thotë, “E shihni këtë lum, këtu nuk ka ujë, më shumë do të ketë gjak se sa që është lumi”. Kështu kam dëgjuar. Unë nuk e kam dëgjuar atë, as nuk kam qenë aty, nuk më kujtohet ajo ditë.

Anita Susuri: E a ju kujtohet kur ata kanë filluar të shkojnë? Si ka qenë ajo?

Franjo Gollome: Kroatët?

Anita Susuri: Si e keni përjetuar ju këtë?

Franjo Gollome: Po ato janë momente të vështira, ato janë momente të vështira. Për shembull ne kemi qenë familje, familjarisht të lidhur. Do të thotë hallat, hallat e mia, babai im do të thotë unë ju kam thënë, unë me xhaxhain kam jetuar. Do të thotë ata çdo natë kanë qenë aty, mos dhashtë Zoti që një natë të mos vij babai im apo halla, menjëherë gjyshja pyet mos ka ndodhur diçka, nuk janë. E afër jemi, njëqind metra. Do të thotë e dini ku keni qenë lart tek gjyshja, aty menjëherë përfundi saj kanë qenë, njëra dhe tjetra hallë. Do të thotë ato dy-tri herë në ditë kanë ardhur aty. Por në mbrëmje patjetër vinin tek ne në darkë, për të bërë komente dhe kështu. Do të thotë kur shkon njëra hallë, pastaj shkon tjetra hallë, shkon djali i hallës, shkon halla thotë, “Duhet të shkoj te fëmijët”. Pastaj shkoi motra ime, pastaj njëri vëlla shkoi, shkoi tjetri vëlla. Prindërit e mi thonë duhet të shkojmë te fëmijët. Të gjitha këto ne shumë rëndë i kemi përjetuar. Mbetesh i vetëm, tani jam mësuar, vet jam, pesë para nuk i jap.

Anita Susuri: Si keni jetuar ato vitet, pas '93-tës, '94-tës?

Franjo Gollome: A dini çka, mundimshëm, mundimshëm. Shumë vështirë, shumë vështirë... Prej '92-tës për mua kanë qenë vitet më të vështira. Prej '92 e deri '98-'99 shumë mundimshëm. Kriza e madhe ka qenë, jam martuar, fëmijët u lindën me shpejtësi e krizë e madhe. Punë jo, dhe pastaj '99-tën diçka pak prapë e fillova tregtinë, pak jam rimëkëmbur. Pastaj pas luftës shumica e janjevasve nuk kanë mundur të lëvizin për shkak të gjuhës por unë edhe xhaxhai kurrë nuk jemi ndalur. Asnjëherë, sa i përket edhe shqiptarëve, edhe turqve edhe serbëve dhe të gjithëve, ne jemi ashtu të rritur, nuk jemi frikësuar kurrë. Dhe kemi pasur telashe. Dy herë kanë dashur të ma vrasin xhaxhain para syve, vetëm se...

Shkojmë te tregu në Lipjan, ne filluam të flasim për kuajt e ai njeriu, ndoshta e ka humbur dikë në luftë dhe rreth këtyre kuajve e ka marr atë çekanin e madh dhe mbrapa u bë gati të godas e ka parë Rrahmani hidhet mbi të. Thotë, "A e din kush është"? Thotë ai është latin. Ai njeriu ka kërkuar falje, çmendet, ka mundur ta vras. Kemi pasur telashe. Kemi pasur telashe aq sa edhe unë jam frikësuar njëherë. Kurrë nuk frikësohem nga asgjë. Njëherë kur kemi qenë në Oshan për të sjellë majë dhe tepsia, sepse xhaxhai ka qenë pa mua në Velekincë i ka parë gratë shqiptare, fëmijët nëpër gurë, në pllaka kanë pjekur bukë, bukë. Dhe ai ka thënë, i ka pasur disa tepsia, i ka ndërruar për njëfarë kali dhe ne i dërguam majë dhe tepsia njerëzve lartë.

Kemi shkuar deri në Oshan, e prej Oshani kur jemi kthyer mbrapa, e pamë atë rrugën e vjetër, rrugën malore, transportuesit nga shkonin do të thotë kë e kanë kapur aty, e vrisnin menjëherë. Unë i them "Rokë, unë më kurrë nuk do të shkoj". Nuk ke çfarë t'ju thuash, nëse të kap ushtria ushtria serbe, do të thotë t'i shohin çantat me majë, sheqerin në kube, dhe i kam thënë unë kurrë më nuk dua. Por nesër prapë kam shkuar. Sapo ne, çka kemi mundur, kemi ndihmuar, në atë stuhi, vijnë njerëzit, nuk kanë sheqer, nuk kanë miell. Gjysmë thesi ty, gjysmë mua hajt'.

Anita Susuri: Kjo ka qenë gjatë luftës?

Franjo Gollome: Po, po, po, po, '99-ta.

Anita Susuri: Më tutje si e keni përjetuar, atë luftën?

Franjo Gollome: Mundimshëm, mundimshëm. E shikon njerëzit po ikin, ne çfarë kemi mundur, ne i kemi mbrojtur për shembull prej Shashkovcit po ikin njerëzit, kështu ka qenë {tregon drejtimin} gratë, fëmijët ikin në mbrëmje. Kë kemi mundur e kemi mbrojtur. Shtëpitë kanë qenë të zbrazëta, të hallës. Sherifi nga Shashkovci dhe gruaja dhe fëmijët vendosen aty. Policia kalonte por ai Millivoja i ynë ka qenë njeri i butë dhe Roka i thotë, "Unë e kam lëshuar Sherifin". "Mirë Roko, ky ujë i trubullt do të kalojë për disa ditë, mirë ke bërë". Por megjithatë ka qenë si komandant aty e të jetë i njoftuar. Do të

thotë nuk është ajo... Atë çka kemi mundur e ryshfetin e kemi mbajtur afër vetes. Fëmijët e mi dhe fëmijët e tij edhe sot kur takohen, ata menjëherë aty prej Sushicës, përshëndeten dhe kështu.

Aty kemi përgaditur, aty kemi ngrënë, pulat bëjnë vezë, sa bukë kemi, aq gatuajmë. Të uritur nuk kemi qenë, e tejkaluam edhe atë. Dhe kështu. Do të thotë për gjithçka duhet njeriu, ka aty kujtime të ndryshme, edhe të fëmijërisë edhe si i rritur dhe do të thotë për gjithçka ka kujtime... Kështu ka qenë, ndoshta nuk do të lejoj Zoti të mos kemi më. Por e gjithë ajo ka qenë e mundimshme, tash jetohe më së miri. Unë kam thënë iks here e njerëzit mendojnë që unë kush e di çka kam. Unë kurrë nuk e mbaj mend prej fëmijërisë që kam pasur më shumë. Edhe ushqim, edhe rehati edhe para dhe të gjitha. Gjithmonë kemi, të gjitha që i kemi pasur më herët, më pak kemi pasur. Unë jam i kënaqur sa i përket asaj, por sot njeriut i mungon çdo gjë. Çdo gjë ka dhe çdo gjë i mungon.

Sa herë ju flas fëmijëve ju them kur kam qenë unë fëmijë, kam ngrënë një herë në javë mish. Pastaj kemi filluar, pikërisht kur kam qenë unë fëmijë, dy herë në javë edhe të enjten. Tash tri herë në javë hamë dhe jemi të uritur. Nuk kemi fuqi të punojmë. Dhe do të thotë ky është tregim i lidhur. Do të thotë gjithnjë e më shumë, kemi më shumë se kurrë për ato 40 vite të mia që unë i kujtoj, ndoshta edhe 45. Do të thotë unë plot 50 vjet i kam.

Anita Susuri: Pas luftës ju prapë, prapë jeni marr do të thotë me blegtori. Si ju ka shkuar atëherë?

Franjo Gollome: Me blegtori dhe tregti, dhe me punimin e tokës do të thotë. Jemi marr me tregti deri para dhjetë vitesh, xhaxhai më shumë kishte dëshirë të bënte tregti por edhe mirë kemi bërë tregti. Nuk kemi përparuar aq shumë por aq mund të përparosh prej asaj. E tani jo, tani jo, tani vetëm me prodhim le të themi. Prodhimet tona, djathi, qumshti, delet, dhitë. Fëmijët punojnë gjatë sezonit dhe kështu jetohe.

Anita Susuri: Ju më keni thënë që i keni tetë fëmijë.

Franjo Gollome: Po.

Anita Susuri: Dhe djali më i madh i ka...

Franjo Gollome: 27.

Anita Susuri: Po. Me çka merren tani ata?

Franjo Gollome: Po ju kam thënë, verës gjatë sezonës është në Kroaci, dimrit vjen këtu, kalon kohën, shëtitet, merremi ne me ja atij i intereson gjuetia. I merr qentë, shkon me shokë, shkon në atë teren, në këtë teren. Ky tjetri ka qejf të shëtis pak, ky djali i tretë i madh njejtë ashtu, rreth bagëtisë, rreth tokës,

në kohën e lirë del deri në Lipjan, në Prishtinë më pak. Del deri në Graçanicë, deri në Slivë, deri këtu, deri atje. Nuk po më intereson aq, nuk dua t'i ndjek djelmoshat nga po dalin, kjo është ajo.

Anita Susuri: A merren edhe ata me blegtori tani?

Franjo Gollome: Po, kur vjen për shembull, të gjithë ne merremi me blegtori, secili, deri te më i vogli. Ja edhe më e vogla kur të shkojmë lartë, ajo thotë, “Unë do të, unë do të”. Te vendi lartë ku e kemi bagëtinë, Bajnica themi “Unë do të shkoj në Bajnicë”. “Po nuk më nevojitesh”. “Të nevojitem babi, unë do të mbledh ushqim për qentë, t'i ushqej”. Hajde vjen edhe ajo shëtitet. Do të thotë të gjithë merremi me blegtori.

Anita Susuri: A keni edhe diçka për fund të na thoni, nëse keni harruar diçka, ndonjë detaj, diçka?

Franjo Gollome: Po nuk më kujtohet. Mjaft ka qenë.

Anita Susuri: Mirë atëherë, ju faleminderit shumë.

Franjo Gollome: Faleminderit edhe juve.